




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së katërt - IV - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.04.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Graiçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Ramadan Jashanica - Drejtor për Financa dhe Buxhet, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Dumani - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Adnan Bullatovci - Udhëheqës i Drejtorisë së Arsimit, Fatlum Berisha - Udhëheqës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Besnik Hykolli - Udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 07.04.2021.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020.
4. Propozim për marrjen e rekomandimeve lidhur me problemet e qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë.
5. Propozim për lejimin e rrënimin të objekteve të vjetra publike në fshatrat Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, Pomozotin dhe Miradi e Epërme.
6. Propozim për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për kompaninë 'Eu-beton' në fshatin Harilaç, për palën Përparim Thaçi.
7. Propozim për shqyrtimin e kërkesës Nr. 01-104/02-0012784/21, për ndërrimin e pronave në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afaristë sh.p.k 'Arbotec', për palën Hektor Beqiri.
8. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë për palën Jeton Kelmendi.
9. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, uroi anëtarët e Kuvendit të Komunës për muajin e shenjtë të Ramazanit, duke u dëshiruar atyre agjërime të lehtë. Lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe pikën shtesë: 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë për palën Jeton Kelmendi'.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme, me pikën shtesë: 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë për palën Jeton Kelmendi'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 07.04.2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 07.04.2021, ju pyes juve tani nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Pasi që diskutime tjera nuk pati lidhur me përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 07.04.2021.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 07.04.2021.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në rrugën 'Aziz Zhilivoda', ku ndodhet edhe Gjimnazi, frekuentimi i njerëzve, banorëve, nxënësve dhe mësuesve është shumë i madh, automjetet kalojnë shpejtë, duhet të vendosen pengesa në rrugë, policë të shtrirë, ku është një shqetësim i banorëve të zonës. E kam edhe një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit nga Këshilli drejtues i shkollës, e ka një kërkesë për rregullimin e fushës së futbollit në oborrin e shkollës 'Selman Riza', e cila është e dëmtuar, kjo fushë duhet të renovohet për nevojat e nxënësve të shkollës. Në oborrin e kësaj shkollë problem tjetër është edhe vërshimi i ujit pas reshjeve të shiut, ky problem duhet të zgjidhet, sa më shpejt sepse rruga aty është e pakalueshme çdo herë pas reshjeve. Për Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban e kam një pyetje, që është edhe shqetësim

i banorëve të fshatit Miradi e Epërme, lidhur me moskryerjen e punimeve në rrugën kryesore nga punëkryesi, banorët e fshatit kanë shumë vështirësi në qarkullim me automjete.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam tri përgjigje tani për anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra, rruga 'Metush Krasniqi' është vetëm një pjesë e saj e pa rregulluar, për arsye të problemeve pronësore të banorëve, rruga e 'Llapit' nuk e ka asnjë dëmtim është e asfaltuar. Po ashtu dua ta jap edhe një përgjigje lidhur me zbatimin e vendimit 151, për të cilin po flisni pa argumente, ky vendim është shfuqizuar nga Kuvendi i Komunës dhe nuk zbatohet nga data 06.09.2020. Sa i përket asfaltimit të rrugës kryesore në fshatin Miradi e Epërme, ky është një projekt publik që financohet nga Ministria e Infrastrukturës, aty kemi probleme me Hekurudhën që po i pengon punimet, lëndën në procedurë gjyqësore tani, shkallën e parë ne e kemi fituar, ata kanë ushtruar ankesë dhe lënda është në shqyrtim në shkallën e dytë.

Aida Alimi: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Kërkoj që Grupi Punues për emërtimin e rrugëve, ta thirrë një mbledhje dhe të fillon me shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për emërtimin e rrugëve. Po ashtu sërish, kemi probleme me mikrofonta në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Jetmir Berisha: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Familjeve që janë vërshuar nga uji dhe janë ndihmuar nga fondi emergjentë i komunës, kërkojmë që t'iu falet tatimi në pronë. Rruga Sllatinë e Madhe/Bardh i Madh/Drenas, ne e kuptojmë që është rrugë rajonale, por në fshatin Graboc i Poshtëm janë hapur shumë gropa dhe kërkojmë që këto të mbulohen me asfalt nga Drejtoria e Planifikimi Urban, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës sepse qytetarët e komunës tonë po kanë shumë probleme në qarkullim. Rruga që i ndërlidhë dy fshatrat: Bardh i Vogël dhe Pomozotin në gjatësi prej 2 kilometra deri te Stacioni i autobusëve, duhet të asfaltohet.

Hysni Hasani: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Unë edhe dje e kam theksuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kam paraqitur, kërkesën për rregullimin e ndriçimit publik në lagjet e komuniteteve, si dhe ndryshimin e propozimit për ndarjen e vijueshmërisë në shkollat të nxënësve nga lagjet 028 dhe 029, ne kërkojmë që nxënësit nga radhët e komuniteteve, të vijnë në mësimin në shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroi se regjistrimi i nxënësve në shkollat, është vendosur nga Grupi Punues i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës, me një gjithëpërfshirje të përfaqësuesve të komuniteteve, drejtorëve të shkollave dhe përfaqësuesit të prindërve, është vendosur që vijueshmëria në shkollat për të gjithë nxënësit të ndahet sipas zonave dhe rrugëve, për të tri shkollat tona në Fushë-Kosovë, andaj sipas ndarjes shumica e nxënësve nga radhët e komuniteteve, sipas rrugëve të caktuara e vijnë në mësimin në shkollat 'Selman Riza' dhe 'Daut Bogujevci'.

Pika e tretë (3) - Propozim për miratimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Të nderuar/a anëtarë të Kuvendit të Komunës, debatin për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020, e kemi zhvilluar në

mbledhjen e datës 07.04.2021, tani e qesim në votim 'Propozimin për aprovimin e Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej të pranishëm njëzet e pesë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020', dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,855,838.58€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 5,196,657.89€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,651,112.96€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,978,551.43€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 29,516.30€.

Pika e katërt (4) - Propozim për marrjen e rekomandimeve lidhur me problemet e qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim, 'Propozimin për marrjen e disa rekomandimeve që përmes kërkesave zyrtare, ne t'i drejtohem organeve qendrore, për adresimin e problemeve të qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë, ku në qytetin e Fushë-Kosovës është i zhvendosur një numër i madh i qytetarëve me prejardhje nga Lugina, që kanë probleme të natyrave të ndryshme, statusore, juridike, sociale e të tjera. Hap diskutiumin.

Aida Alimi: Propozimi për marrjen e disa rekomandimeve për adresimin e çështjeve të qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Fushë-Kosovë, është i qëlluar, unë këtë e kam kërkuar që nga fillimi i mandatit tim në Kuvend, para tetë viteve, sepse këta qytetarë kanë probleme të shumta dhe të pa zgjidhura statusore dhe sociale për familjet e tyre. Unë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kam kërkuar që të mbahet në dëgjim publikë me këtë qytetarë dhe ne pastaj të vendosim, për këtë punë në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës, të kompletohet edhe më shumë ky propozim në përmbajtjen e tij, sepse vetëm ata qytetarë mund të sqarojnë drejtë, pozicionin dhe kërkesat e tyre, për vendosje nga organet qendrore dhe lokale.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tekstualisht propozimi është i njëjtë me vitin e kaluar, unë pyes cili është ndryshimi nga atëherë deri tani. Trajtimi i këtyre qytetarëve që jetojnë në komunën tonë, duhet të bëhet në mënyrë serioze, ne i përkrahim rekomandimet që ofrojnë zgjidhje konkrete, por këto rekomandime janë shumë relative dhe të përgjithshme. Unë tani dua të theksoi, se deri tani janë bërë përpjekje të vogla herë pas herë për adresimin e çështjeve të tyre.

Eglantina Azemi: Unë pyes, pse Kryetari i Komunës nuk është prezentë në këtë mbledhje, kur e parashtron vetë për diskutim një punë të tillë. Pyes, a ka problem të takohet me këta qytetarë, apo çka, ku qëndron problemi.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, përkrah dhe inkurajon Drejtorinë e Administratës dhe Zyrën Ligjore, që brenda

mundësive që lejohen me legjislacion, të radhitë për shqyrtim problemet e qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Fushë-Kosovë, por këta qytetarë kanë probleme të mëdha statusore dhe juridike, që janë të ndërlikuara dhe nuk mund të zgjidhen nga niveli komunal, andaj duhet të adresohen në nivelin qendrorë për shqyrtim.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë mendoi se shqyrtimi i kësaj çështje është i vonuar, ne e dimë se qytetarët me origjinë nga Lugina e Preshevës kanë probleme të ndryshme, por problemet e tyre nuk duhet të veçohen nga qytetarët e tjerë të komunës, sepsë me përjashtim të çështjeve statusore të tyre, problemet tjera janë të njëjta dhe duhet të zgjidhen. Të gjithë ne e dimë se Komuna e Fushë-Kosovës, qyteti ynë Fushë-Kosova është një Kosovë e Vogël, e gjithë shqiptarisë këtu, me ardhje të njerëzve nga regjione të ndryshme si: dugagjini, llapi, lugina e tjerë. Njëheritë thesatoi se çështjet administrative dhe statusore duhet të ngritën dhe zgjidhen nga niveli qendrorë, nga Qeveria e Kosovës. Ne jemi për ngritjen dhe adresimin e këtyre problemeve për zgjidhje, vetëm kërkojmë që kjo punë, të mos jetë e jashtëzakonshme dhe në përdorim të politikës ditore.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Është shumë mirë që kjo çështje është për trajtim në rendin e ditës sot, këta qytetarë në aspektin e vendbanimit kanë mbetur keqë pa zgjidhje, as këtu, as atje, ne e dimë se shumica e tyre jetojnë në Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Gjilan, andaj niveli qendrorë duhet të punon për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky shqetësim për qytetarët tanë nga Lugina e Preshevës, është evidentë që nga viti 1999 dhe 2001, ne si shtet i ri është dashur të kujdesemi më shumë për këta banorë, familjet e të cilëve janë të koncentruara në tre Komuna të Kosovës si në: Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Gjilan, për këtë punë duhet të kujdeset Qeveria në nivel vendi, të evidentohen këta banorë, të punohet për zgjidhjen e problemeve të tyre. Ne kemi fjetur, armiku ynë atje nuk flenë, i bënë në kohë ç'regjistrimin e njerëzve atje nga regjistri civil i banorëve, ne kemi edhe familjarë tonë dhe i dimë hallet dhe brengat e këtyre banorëve, andaj duhet të veprojmë në mënyrën e duhur edhe në aspektin kohorë.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Marrja e veprimeve konkrete që i zgjidhë problemet e Luginës, kurrë nuk është vonë, ky propozim ka qenë në rendin e ditës edhe vitin e kaluar, por nuk janë marrë veprime konkrete, sepse ka qenë kohë e fillimit të pandemisë. Unë jam me origjinë nga Komuna e Bujanocit, fshati Smolicë dhe i njoh këto probleme, qytetarët e këtij rajoni vuajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre, de fakto ata jetojnë një pjesë e madhe në komunën tonë, shumë prej tyre nuk kanë dokumentacion valid civil, atje shteti i Serbisë i shlyenë nga regjistri civil. Ne si Legjislativë i Komunës, mbështetur në propozimin e dhënë për ngritjen e çështjes nga Ekzekutiv i Komunës duhet ta përgatitim një rezolutë me radhitjen real të çështjeve, që i preokupojnë qytetarët e Luginës, ta kemi një debat publikë për këto probleme, nuk bëhet vonë për një muaj, të dëgjojmë sugjerimet dhe shqetësimet e tyre, t'i mbështesim dhe argumentojmë ato. Në këtë propozim, ne nuk dimë, as çka duhet të mbështesim, janë paraqitur dy raste aty, ne kërkojmë zgjidhje reale, jo propozime për arsye politike, sepse të gjithë e dimë rëndësinë e këtij komuniteti, që vepron dhe jeton me vite në Komunën e Fushë-Kosovës.

Driton Ademi: Ne si nivel komunal mund të përkrahim vetëm ndonjë rekomandim, që ndikon direkt në përmirësimin e shërbimeve publike dhe administrative për këtë qytetarë, por nuk mund të ndërhyjmë në çështjet statusore, ato i rregullon ligji, është Departamenti i caktuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, ne duhet vetëm të radhitim dhe adresojmë problemet e tyre reale, nuk kemi kompetencë lëndore dhe as funksionale për zgjidhjen e tyre.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne me këtë propozim kemi patur qëllim, që ta ngrisim për diskutim dhe trajtim real këtë çështje nga niveli qendrorë. Ne e kemi marrë iniciativën, unë pajtohem me mendimet e parafolësve të mi lidhur me kompetencat në këtë fushë, ne tani e kemi një Qeveri të Kosovës, e cila në programin e saj e promovon Bashkimin Kombëtarë, synimi ynë për përmirësimin e statusit të këtyre qytetarëve, është që niveli qendrorë të mirret me problemet e tyre reale dhe atë jo vetëm në aspektin deklarativ.

Pas sqarimeve tjera shtesë, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim, 'Propozimin që Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, t'i drejtohet me kërkesë zyrtare, Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës së Kryeparlamentarit të Republikës së Kosovës, për adresimin e problemeve statusore, sociale dhe problemeve tjera të qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë, ku numri më i madh i tyre jeton dhe vepron në territorin e Komunës tonë.

U votu unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se me unanimitet të votave Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, i drejtohet me kërkesë zyrtare: Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës së Kryeparlamentarit të Republikës së Kosovës, për adresimin e problemeve statusore, sociale dhe problemeve tjera të qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë, si vijon:

Kërkesë zyrtare lidhur me problemet e qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë për:

- Presidencën e Republikës së Kosovës, Presidenten znj. Vjosa Osmani Sadriu;
- Kuvendin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit z. Glauk Konjufca dhe
- Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kryeministrin z. Albin Kurti

Pika e pestë (5) - Propozim për lejimin e rrënimit të objekteve të vjetra publike në fshatrat Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, Pomozotin dhe Miradi e Epërme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e rrënimit të objekteve të vjetra publike në fshatrat: Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, Pomozotin dhe Miradi e Epërme, me synimin që të ndërtohen dy Qendra të reja të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Sllatinë e Madhe dhe Bardh i Madh, si dhe lirim të hapësirave për rekreacion dhe sport për banorët e fshatrave: Pomozotin dhe Miradi e Epërme. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e kemi shqyrtuar dhe analizuar: Propozimin për rrënimin e dy objekteve të vjetra të ambulantave, andaj e përkrahim propozimin për ndërtimin e dy Qendrave të reja Mjekësisë Familjare në fshatrat: Sllatinë e Madhe

dhe Bardh i Madh. Në fshatin Bardh i Madh objekti i ri shëndetësorë është duke u ndërtuar nga donatori, është një objekt modern që i plotëson nevojat e popullatës së zonës në fjalë, për shërbime më të mira shëndetësore, ndërsa për objektin në fshatin Sllatinë e Madhe është i ndarë fondi dhe objekti i ri shëndetësorë, do të ndërtohet sipas standardeve për shërbime të qasshme shëndetësore. Për objektin shkollorë në fshatin Pomozotinë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, është thënë se ky objekt i vjetër shkollorë duhet të ruhet, por na është sqaruar se ky objekt publikë nuk hynë në kuadër të objekteve arkeologjike dhe në fshatin Miradi e Epërme, shtëpia e vjetër e kulturës është shkatërruar shumë, hapësira aty është shumë e nevojshme për fëmijët dhe rininë e fshatit, andaj objekti në fjalë duhet të rrënohet.

Arjeta Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne banorët e fshatit Miradi e Epërme kërkojmë që objekti i vjetër i Shtëpisë së Kulturës të rrënohet, pasi që është objekt i dëmtuar shumë dhe paraqet një vend të rrezikshëm, që nga të rinjët po shfrytëzohet edhe për dukuri negative, ne kërkojmë që në atë hapësirë të ndërtohet një miniparkë, i cili duhet ta ketë edhe një murë mbrojtës, që e kufizon atë me pjesët private të pronave, meqë hapësira në fjalë do të shfrytëzohet nga rinia e fshatit për rekreacion dhe sport.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Objekti në fshatin Sllatinë e Madhe për neve ka një rëndësi të veçantë, sepse aty janë zhvilluar shumë aktivitete kombëtare dhe shoqërore, andaj nuk duhet të rrënohet ky objekt, por të rregullohet dhe mos të lihet hapësira aty në mëshirën e uzurpatorëve, që prona publike të tjetërsohet, pronat publike duhet të ruhen nga të gjithë ne. Në kohën më të vjetra, ne nga fshati Henc kemi udhëtuar këmbë deri atje për ta shikuar televizorin, kur punonte aty z. Fazli Haziri. Edhe objekti i ambulantës në fshatin Henc është demoluar shumë, është marrë një vendim për shndërrimin e këtij objekti publikë në shtëpi pritëse për nevojat e fshatit, por nuk janë kryerë investimet e kërkuara dhe vendimi në fjalë nuk është realizuar asnjëherë.

Nënkryetari i Komunës: Fjala është për objektin e vjetër të ambulantës, jo të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Sllatinë e Madhe, objekti i ri shëndetësorë do të ndërtohet në hapësirën e njëjtë. Ne nuk do të lejojmë që askush të përfiton aty, hapësira aty është e nevojshme për ndërtimin e një objekti të ri shëndetësorë, sipas standardeve të reja të ndërtimit.

Driton Ademi: Nëse e marrim kontekstin kohor, ashtu sikur është renovuar shkolla e fshatit Henc, duhet të renovohet edhe Shtëpia e Kulturës në fshatin Miradi e Epërme, objektet e vjetra mund të zëvendësohen me objekte të reja, vetëm atëherë kur e kanë të lartë koston e mirëmbajtjes së tyre dhe lejohen të rrënohen, meqë nuk kanë vlera të trashigimisë arkeologjike dhe arkitektonike të ndërtimit të tyre.

Ali Ismaili: Unë jam Imam i Xhamisë në fshatin Miradi e Epërme dhe banorët aty janë 100%, që objekti në fjalë të rrënohet, por propozimet e paraqitura këtu nga Ekzekutivi i Komunës, duhet ta kenë një arsyeshmëri kur propozohen të rrënohen, ne këtu nuk e kemi asnjë sqarim të detajizuar, ne nuk mund dhe nuk duhet, të pajtohemi me propozime të njëanshme të Ekzekutivit të Komunës.

Sabit Bullatovci: Këtu propozohen të rrënohen katër objekte publike, ku janë sipërfaqet e tyre, fletat poseduese me kopje të planit. Ne në fshatin tim e kemi rrënuar shkollën e vjetër të ndërtuar në vitin 1965, është oborri e shkollës është ndërtuar shkolla e re moderne, me objekt më të mirë.

Në fshatin Sllatinë e Madhe ne nuk e dimë hapësirën e objektit shëndetësorë, aty ka uzurpime, ne jemi në lajthitje. Shtëpia e Kulturës në fshatin Miradi e Epërme ka funksionuar në vitet e tetëdhjeta, aty ka funksionuar çdo gjë, ka patur shafqje, pse nuk është renovuar ky objekt. Vërejtja ime për komunën është, pse mungon siparfaqja e këtyre ngastrave kadastrale, ku ndodhen objektet e vjetra publike tani?

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për rrënimin e objekteve të vjetra publike në fshatrat: Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, Pomezotinë dhe Miradi e Epërme'.

U votua me: njëzet vota 'për', asnjë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për rrënimin e objekteve të vjetra publike në fshatrat: Sllatinë e Madhe, Bardh i Madh, Pomezotinë dhe Miradi e Epërme' dhe mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për rrënimin e objekteve të vjetra dhe të dëmtuara në fshatrat Komunës së Fushë-Kosovës si vijon:
 - 1.1 Të rrënohet objekti i vjetër i Ambulancës së Mjekësisë Familjare, në fshatin Sllatinë e Madhe, me qëllim të ndërtimit të objektit të ri publik shëndetësor për plotësimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative për banorët e fshatrave përreth si: Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Harilaç dhe Henc;
 - 1.2 Të rrënohet objekti i vjetër i Ambulancës së Mjekësisë Familjare, në fshatin Bardh i Madhë, pasi që objekti i ri shëndetësorë është në ndërtim e sipër;
 - 1.3 Të rrënohet objekti i vjetër i shkollës, në fshatin Pomezotin, për krijimin e hapësirës për nxënës dhe rininë e fshatit;
 - 1.4 Të rrënohet objekti i vjetër i Shtëpisë së Kulturës, në fshatin Miradi e Epërme, pasi që paraqet rrezik nga vjetërsia e tij dhe demolimi. Qëllimi i rrënit është rritja e hapësirave për aktivitete për fëmijët dhe rininë e fshatit.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për Kompaninë 'Eu Beton' në fshatin Harilaç, për palën Përparim Thaçi.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për Kompaninë 'Eu Beton' në fshatin Harilaç, për palën Përparim Thaçi', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Propozimi në fjalë është bërë në bazë të dispozitave, të Ligjit për tokën bujqësore dhe Udhëzimit administrativ numër 41/2006, nenit 5, paragrafi 6, objekti në fjalë është në sipërfaqe prej 1210m², ju në material e juaj e keni fletën poseduese në emër të subjektit afaristë dhe kushtet ndërtimore, është tokë e marrë në qirambajtje për 99 vite sipas legjislacionit në fuqi. Kjo punë është në kompetencë të Kuvendit të Komunës që të vendos sipas ligjit.

Durim Hajra: Pyes, pse shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nuk po bëhet duke u mbështetur në Hartën Zonale të Komunës, e miratuar në Kuvendin e Komunës.

Drejtori për Planifikim Urban: Arsyeja e vetme është se Ligji për tokën bujqësore, është nxjerrë në vitin 2006 dhe nuk është i harmonizuar me Ligjin për planifikimin hapësinorë dhe kjo punë, nuk ka ndryshuar për gjashtëmbëdhjetë vite.

Migjen Kolshi: Në fshatin Harilaç e ushtrojnë veprimtarinë e tyre afariste tre betonjerkja, a kanë leje të punës ata, sepse kemi informata se disa nuk kanë leje të punës.

Drejtori për Planifikim Urban: Nuk kanë leje, por do të trajtohen sipas Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, sipas rregullave të parapara secila betonjerkë që prodhon mbi pesë metër kubë beton, duhet të pajiset me pëlqimin mjedisorë, ne nuk kemi kompetenca, lejen për veprimtarinë e tyre ato e marrin në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, neve vetëm na njoftojnë për këtë punë.

Naser Graiçevci: Ne e kuptojmë se kompetencat në këto raste janë të ndërlidhura ndërmjet Ministrisë dhe Komunës, por së pari kërkohet një pëlqim nga komuna ku operon subjekti afaristë.

Drejtori për Planifikim Urban: Këto objekte zakonisht janë objekte montazhë, si dhe janë të pajisur me leje për operim nga Ministria.

Driton Ademi: Në fushatën e fundit zgjedhore premtimi i Kryetarit të Komunës ka qenë, ruajtja e tokave bujqësore, ndërsa tani po veprohet në drejtimin e kundërtë me premtimet e juaja.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Kompaninë 'Eu-Beton', në fshatin Harilaç, për palën Përparim Thaçi'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', tre 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Kompaninë 'Eu-Beton', në fshatin Harilaç, për palën Përparim Thaçi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 246, të datës 20.04.2021, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në ngastrën kadastrale Nr. P-725140003-00779-7, me sipërfaqe S=9,900m², arë e klasës së pestë, pronë private në vendin e quajtur 'Shume Krivovo' në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afarist Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar 'Eu - Beton', me numër identifikues të biznesit 811327205, pronar Përparim Thaçi.
2. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për zhvillimin e biznesit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 'Eu-Beton', në Zonën Industriale ZI I - Blloku 1215.

Pika e shtatë (7) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës Nr. 01-104/02-0012784/21, për ndërrimin e pronave në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afaristë sh.p.k 'Arbotec', për palën Hektor Beqiri.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës Nr. 01-104/02-0012784/21, për ndërrimin e pronave në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afaristë sh.p.k 'Arbotec', për palën Hektor Beqiri', ju njoftojmë se është lëshuar një gabim teknik,

meqë këtu kemi të bëjmë me ngastrën kadastrale me numër 00779-3 dhe jo 4, me ngastrën kadastrale 00002-0. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Sipas legjislacionit në fuqi, kjo pikë e rendit të ditës nuk është dashur të vjen fare për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, por ky propozim duhet të jetë me kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe jo të palës, këtu kemi të bëjmë me një shkelje të ligjit, sepse për ndërrimin e pronave duhet të ekzistojë interesi i veçantë publikë i komunës.

Driton Ademi: Ndërrimin e pronave në këtë formë si është propozuar Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, nuk e lejon.

Durim Hajra: Në rastin konkret nëse një pronë ndodhet te Kompleksi i banesave 'Apollonia' në Fushë-Kosovë, sipas këtij parimi të njëjët ne mund ta themi se është interes i veçantë dhe mund ta ndërrojmë, kjo punë nuk bëhet kështu, pronat për ndërrim bëhen me propozim të Kryetarit të Komunës, vetëm kur kemi interes publikë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për këmbim pronën e palës të evidentuar në ngastrën kadastrale 00779-3, me ngastrën kadastrale 00002-0, në Zonën Kadastrale Harilaç.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej trembëdhjetë anëtarë të pranishëm që marrin pjesë në votim.

Në bazë të pjesëmarrjes në votim, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstaton se propozimi në fjalë nuk kalon, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Pika e tetë (8) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërimin shëndetësorë të palës Jeton Kelmendi.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërimin shëndetësorë të palës Jeton Kelmendi', i cili pas luftës ka rënë në mina dhe duhet ta vendos protezën për secilin vitë. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Unë e njoh rastin në fjalë dhe jam për aprovimin e kësaj kërkesë, por kjo nuk është dashur të vjen në Kuvendin e Komunës për shqyrtim, me arsyetimin se hap rrugë për kërkesat tjera dhe buxheti është i kufizuar, nuk mund t'i ndihmojmë të gjithë njerëzit që kanë nevojë.

Naser Graiçevci: Këto raste nuk duhet të trajtohen në mënyrë selektive, sepse të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë të palës Jeton Kelmendi'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë të palës Jeton Kelmendi' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për shërim shëndetësorë dhe rehabilitim, për palën Jeton Kelmendi nga fshati Sllatinë e Vogël, për vendosjen e protezës së këmbës së majtë prej gjurit sipas diagnozës: Amputatio cruris sin pp vulnus explosivum.

Pika e nëntë (9) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që anëtarët e Kuvendit të Komunës, që janë prekur nga pandemia Covid - 19, duhet të kompensohen me medita për mbledhje, sepse ata kanë munguar pa vullnetin e tyre, nuk duhet t'iu hyjmë në hak, sepse atyre nuk i'u është mundësuar, pjesëmarrja online në mbledhjen e Kuvendit të Komunës nga Administrata e Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Lidhur me denoncimin e Shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje z. Durim Hajra, kjo qasje jo korrekte nuk i hynë në punë askujt, shkakton problem me media, kur thuani pa të drejtë se janë keqpërdorë shuma e mjeteve financiare prej 699,000.00€, si tërësi dhe jo si pjesë e saj, vijnë televizionet T7 dhe të tjera, pyesin për këtë denoncim tuajin. Unë e kam sqaruar se kjo nuk qëndron, mund të jetë pjesë e shumës, pjesë është, edhe 5%, edhe 95%, ju keni dashur të flisni për shumën prej: 89,000.00€, që ka qenë në vendimin e Kuvendit të Komunës 'për blerjen e testeve dhe shërbimeve shëndetësore tjera', është dashur ta ndani e jo të flisni kotrum pa argumente, sipas juve na është dashur ta presim armën e zbrazët, pa plumb, kjo nuk shkonë kështu, ju kemi sqaruar secilën herë se Drejtoria e Financave dhe Buxhetit është e gatshme ta ofron dokumentacionin e shpenzimeve, të cilin keni mundur ta shikoni të detajizuar ju si anëtarë të Kuvendit të Komunës, por ju e keni zgjedhur të bëni fushatë me këtë punë, si Lëvizje Vetëvendosje duke e paraqitur punën e komunës në aspektin negativ, duke folur të pa vërteta dhe duke e mashtruar opinionin, për këtë keni përgjegjësi z. Durim Hajra, por do të del e kundërta e asaj që e keni thënë ju.

Durim Hajra: Unë në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, pasi që i kemi kërkuar raportin për këto shpenzime në Kuvendin e Komunës, të cilat nuk i kemi marrë, kemi ushtruar një kallëzim penal në Stacionin Policorë në Fushë-Kosovë, kjo nuk është luftë individuale e imja, këtë unë e kam bërë në cilësinë e Shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kjo është e para, ndërsa e dyta këtu nuk kemi nevojë të flasim me emëra të përvetëshëm, unë mbajë përgjegjësi për veprimet e mia në aspektin politikë. Si përfaqësues i qytetarëve, ne jemi thirrë në transparencë, sepse ju e keni neglizhuar ofrimin e dokumentacionit për shpenzimin e mjeteve financiare për menaxhimin e pandemisë Covid - 19. Është dashur ta kemi një raport të detajizuar financiarë, për menaxhimin e pandemisë nga Shtabi Emergjentë i Komunës, këtë nuk e kemi marrë. Unë këtë punë nuk e kam bërë në aspektin privat, por në aspektin politikë, kam adresë, i nderuari Nënkryetar i Komunës jam përfaqësues politikë i votuesve të subjektit tim politikë, si dhe kam përgjegjësi, kjo nuk ka lidhje me fushatë zgjedhore. Nëse dikush, ka keqpërdorë, janë organet kompetente që e verifikojnë këtë punë. Nuk ka patur nevojë që unë të linçohem publikisht.

Nënkryetari i Komunës: Unë nuk po dua ta mbrojë askënd, por kur flisni për diçka duhet ta ndani procesin, fjala ka qenë për shumën prej: 89,000.00€ për testet shëndetësore, e jo për 699,000.00€, euro, si keni thënë ju, se janë keqpërdorë, në këtë rast po të jetë kështu duhet të aktivizohet Prokuroria, por kjo punë me këtë qasje është një tendencë e pastër politike, për ta njëllusor pa të drejtë punën e komunës. në fillim janë bërë teste serologjike në Spitalin 'Euromed' për punëtorë,

aty kur kanë dëgjuar shkuar atje edhe qytetarë, për këtë punë janë shpenzuar vetëm shuma prej: 3,300.00€, pastaj e kemi ndërprerë, me pjesën tjetër të mjeteve financiare janë blerë pajisje shëndetësore, për nevoja të pacienteve në kohën e pandemisë, për secilën furnizim me material shëndetësorë janë raportet, është blerë edhe miell për furnizim të qytetarëve në nevojë, atyre me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, ju jeni të lirë ta shikoni dokumentacionin për secilin shpenzim.


Driton Ademi: Lidhur me diskutimet e Nënkryetarit të Komunës z. Fadil Krasniqi dhe anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra, na jemi të dëmtuar, sepse nuk na janë dhënë këto raporte për shpenzime. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna është përsôn juridikë dhe ka të drejtë të ushtron padi ndaj subjekteve tjera dhe individëve, por edhe mund të paditet, në aspekti juridikë kjo punë është në rregull, kur puna del në media, aty verifikohet se mungon transparenca për shpenzimet e realizuara. Në fillim të mandatit tonë kur unë e kam ngritur çështjen e mosfunksionimit të mikrofonave, në sallën e Kuvendit të Komunës, të tjerët kanë bërë hajgare, me vonë kjo është parë si mungesë në punën normale të organit më të lartë të komunës.

Nënkryetari i Komunës: Këtu është bërë një porpagandë se gjoja është keqpërdoruar shuma e mjeteve financiare prej 699,000.00€, ndërsa fjala ka qenë për shumën e mjeteve financiare prej vetëm 89,000.00€ për teste shëndetësore, ku pjesë e shumës mund të jetë, edhe 5% e saj, edhe 95% e saj.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:30 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

